

PËRMBLEDHJE E MINUTAVE TË MBLEDHJES

KËSHILLI I INVESTIMEVE (KI)

MBLEDHJA XXXIII

“Sfidat e Sektorit Privat: Administrimi Fiskal, Inovacioni, Produktiviteti”

Tiranë, 26 mars 2024, 11:30 – 13:00

Mbledhja u drejtua nga Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, z. Blendi Gonxhja, Kryetar i KI. Në mbledhje morën pjesë 19 anëtarë të KI dhe rreth 30 vëzhgues – përfaqësues të shoqatave të biznesit vendas dhe të huaj dhe institucioneve shtetërore në Shqipëri.

Hapja e Mbledhjes nga Ministri Blendi Gonxhja, Kryetar i KI

Në fjalën e tij hyrëse, Ministri Gonxhja theksoi progresin në modernizimin e ndërveprimeve qeveri-biznes nëpërmjet përmirësimit të komunikimit me administratën tatimore dhe aplikimit të gjerë të shërbimeve elektronike. Ndërsa paraqiti disa rezultate pozitive të reformave fiskale, ai theksoi gjithashtu rëndësinë e balancimit të formalizimit dhe inovacionit për të mbështetur sipërmarrësit. Gjithashtu, Ministri Gonxhja theksoi rëndësinë e ndërhyrjeve në zhvillimin e strategjive afatgjata të mbledhjes së të ardhurave dhe nxitjen e angazhimit dhe transparencës në sektorë për të nxitur rritjen e qëndrueshme të ekonomisë. Ministri Gonxhja falenderoi Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Sekretariatit Shtetëror Zviceria për Çështje Ekonomike (SECO) për mbështetjen e tyre në platformën e KI për përmirësimin e klimës së biznesit në vend.

Prezantimi i Sekretariatit të Këshillit të Investimeve

Znj. Diana Leka (Angoni), Sekretariati i KI, prezantoi shkurtimisht gjetjet kryesore të analizës së Sekretariatit, duke theksuar sfidat e biznesit në katër fusha kryesore: ndërveprimi me administratën tatimore dhe fiskalizimi, informaliteti, produktiviteti, inovacioni dhe barra rregullatore. Ndër rekomandimet e propozuara (*të përfshira në notën teknike të dërguar parapraakisht elektronikisht tek anëtarët*) u përmend adresimi i problematikave që lidhen me paqëndrueshmërisë fiskale dhe mireadministrimin fiskal, përmirësimi i nivelit të formalizimit, stimulimi i inovacionit të biznesit përmes masave si përsheptimi i amortizimit dhe ndërgjegjësimi i bizneseve mbi përfitimet nga inovacioni dhe investimi në kërkim dhe zhvillim.

Përmbledhje e diskutimeve kryesore

Ministria Delina Ibrahimaj, shprehu vlerësimin për punën e Këshillit të Investimeve, duke theksuar rëndësinë e tij si një forum që tregon seriozitet në analiza dhe rekomandime mbi politika që ndikojnë në klimën e biznesit në vend dhe bashkëpunimit në identifikimin e nevojave për reforma madhore në aktivitetin e biznesit. Ajo u shpreh se nota më e fundit teknike e Sekretariatit adreson elementë të diskutuar më parë, por që megjithë përpjekjet e përbashkëta ende ka nevojë për punë të thelluar (grupe pune) në drejtim të stabilitetit fiskal e nxitjes së produktivitetit për modernizimin e sektorëve prodhues.

Znj. Ekaterina Solovova, BERZH, i uroi mirëseardhjen ministrit Gonxhja si kryetar i ri i KI-së, ndërsa falenderoi Ministren Ibrahimaj për pjesëmarrjen e vazhdueshme dhe aktive. Ajo vlerësoi

rëndësinë e temës së kësaj mbledhje në kuadër të përmirësimit të konkurrueshmërisë së bizneseve shqiptare. Ndërsa i afrohem dhjetëvjetorit të funksionimit të KI, znj. Solovova vlerësoi punën e kryer në organizimin e 33 mbledhjeve plenare, mbi 100 mbledhje në grupe të fokusuara/grupe të punës për të diskutuar çështjet në nivel teknik, konsultimin e rreth 450 përfaqësuesve të biznesit dhe miratimin e 326 rekomandimeve, ku gati gjysma janë të zbatuar apo në proces, me një kontribut konkret në përmirësim të klimës së biznesit në vend. Ajo vuri në pah vlerësimin e KI-së si një platformë efikase të dialogut publik-privat, e dëshmuar edhe nga rritja e interesit nga shoqatat dhe dhomat e biznesit për t'u anësuar, duke çuar në rritjen e anëtarësimit të tyre në KI. Znj. Solovova vlerësoi gjithashtu angazhimin e vazhdueshëm të Qeverisë Shqiptare ndaj KI dhe mbështetjen e SECO-s. Ajo përfundoi duke nënvizuar rëndësinë e dialogut midis BERZH-it, qeverisë dhe sektorit privat në lidhje me klimën e biznesit në Shqipëri.

Ministri Blendi Gonxhja, shprehu nevojën për koordinim dhe përmirësim të informacionit në lidhje me aplikimet për grante dhe programe. *Ai propozoi një faqe të përbashkët të internetit ku të bashkohet dhe të kategorizohet informacioni për të gjithë aplikuesit, duke siguruar që të gjithë të kenë qasje të qartë dhe të plotë në informacionin e tyre për afatet dhe mundësitë për të cilat mund të aplikojnë.* Në këtë drejtim, Ministri Gonxhja propozoi ndërmarrjen e një përpjekje të përbashkët për të rritur efikasitetin dhe transparencën në procesin e aplikimit për grante dhe programe.

Ministrja Delina Ibrahimaj, përgëzoi Sekretariatit për punën e kryer dhe vlerësoi rëndësinë e temave që po diskutohen në këtë tryezë të cilat kërkojnë një vëmendje të veçantë dhe grupe pune teknike të thelluara. Duke iu referuar analizës më të fundit të Sekretariatit dhe jo vetëm, Ministrja ngriti pikat e mëposhtme:

- Ndonëse sektorët e bujqësisë dhe industrisë kanë pësuar rritje, produktiviteti ka qenë i ulët dhe shprehu nevojën për masa të veçanta për rritjen e tij. Për këtë, ajo përmendi punën e vazhdueshme të ndërmarrë në kuadër të strategjisë S3, si një hap paraprak për identifikimin e treguesve specifikë, për të mundësuar më shumë njohuri se ku duhet të jetë fokusi. *Produktiviteti në të dy sektorët e sipërpërmendur do të mund të rritet nëpërmjet ndërhyrjes në (a) kapitalin njerëzor (sipërmarrjet dhe njohuritë dhe njerëzit) dhe (b) rritjen e aksesit në financim.*
- Nevojën për një qasje horizontale (si dixhitalizimi, etj.) dhe sektoriale për të adresuar çështjet që lidhen me informalitetin dhe ndërveprimin e tyre në sektorë të ndryshëm. Është një punë që Këshilli Ekonomik Kombëtar (KEK) ka ndërmarrë për të çuar përpara dhe zhvilluar. Ajo e ftoi KI-në të bashkëpunojë nëpërmjet (a) ekspertizës dhe (b) duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet anëtarëve të KI-së për të bashkëpunuar përmes grupeve të punës të krijuara për analiza sektoriale.
- Nënvizoi rëndësinë e draft-rekomandimeve të KI-së për *nevojën për një informacion më të strukturuar dhe akses të thjeshtuar në financim për bizneset.* Ajo informoi se qeveria ka nisur reformën në lidhje me ristrukturimin e dhomave të tregtisë për të maksimizuar kontributin e tyre në procesin e vazhdueshëm të integritetit evropian të Shqipërisë. Dhomat do të luajnë një rol vendimtar në edukimin e biznesit, ndërkohë që do të ndihmojnë në shpërndarjen e informacionit kyç të rëndësishëm për çdo subjekt biznesi. Gjithashtu, ministrja nënvizoi iniciativat e ndryshme të drejtuara drejt krijimit të shërbimeve këshillimore për biznesin (p.sh. one-stop-shop), të krijuara për të ndihmuar bizneset në navigimin e procedurave të aplikimit për fondet e BE-së, duke rritur besimin ndaj procesit dhe duke përmirësuar cilësinë e informacionit.

Z. Nikolin Jaka, Dhoma e Tregtisë Tiranë, shprehu vlerësimin për krijimin e Ministrisë së Ekonomisë si një hap të rëndësishëm për biznesin, duke e cilësuar si domosdoshmëri për klimën e biznesit. Ai përgëzoi axhendën e re të Ministrisë duke e etiketuar atë si agresive për përmirësimin klimës së biznesit dhe koordinimin e sektorëve të ekonomisë. Z. Jaka vlerësoi punën dhe

rekomandimet e KI dhe shprehu nevojën që këto rekomandime të merren seriozisht nga institucionet përkatëse gjatë hartimit dhe zbatimit të drafteve dhe platformave dhe/apo akteve ligjore dhe nën-ligjore. Në lidhje me disa nga sfidat kryesore të biznesit, ai përmendi:

- Rëndësinë e sigurisë juridike fiskale dhe nevojën për të përmirësuar sigurinë juridike për investitorët dhe prodhuesit vendas, veçanërisht thelbësore për sipërmarrjet që hartojnë plane afatmesme dhe afatgjatë për zhvillimin e kompanive të tyre.
- Nevoja për një strategji për të mbështetur prodhimin dhe eksportin vendas, që konsideron mbështetjen për prodhuesit dhe investitorët shqiptarë, p.sh. të identifikojë një sektor që ka potencial investimi dhe të përgatisë paraprakisht një paketë të plotë dhe specifike ligjore/rregullative që në mbështetje të zbatimit të projektit të marrë në konsideratë edhe të gjitha sfidat që lidhen me tokën, energjinë, etj.
- Nevojën për bashkëpunim midis dhomave të tregtisë dhe organizatave për krijimin e modeleve për aksesin në financë për çdo thirrje duke sjellë si shembull modelin e krijuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për inkurajimin e modelit të vetëprodhimit duke rezultuar në rritjen e sipërmarrjeve që vetëprodhojnë energjinë e tyre në vetëm pak vite.

Znj. Elisabeta Katiaj, Dhoma e Biznesit të Diasporës, theksoi tre pika kryesore:

- Nevoja për ngritjen e qendrës së inovacionit dhe ekselencës për sektorin privat për të përmirësuar konkurrueshmërinë. Zakonisht thirrjet për fonde që iu ofrohen startup-eve janë të vogla, të nivelit EUR 10,000 – 15,000, ndërkaq vetëm konsulenca për një zhvillim biznesi kushton kaq. Për këtë arsye, në një farë mënyre, krijimi i një qendre të ekselencës për sektorin privat shihet si emergjente pasi shumicave e bizneseve në vend janë biznes i vogël dhe i mesëm. Në vende si Gjermania, Italia, etj., janë me mijëra ekspertë të atashuar nëpër këto qendra, të cilët kundrejt pagesës apo suportit të marrëdhënies publik-privat, i ofrojnë biznesit konsulencën e nevojshme. Biznesi ka nevojë të kualifikohet dhe të edukohet me mënyrën e qeverisjes. Standardizimi, industrializimi dhe ndërkombëtarizimi janë thelbësore për të inkurajuar NVM-të të zgjerohen ndërkombëtarisht. Të tre këto faza kërkojnë të niset nga konsulenca, dhe këto qendra të inovacionit dhe ekzistencës për sektorin privat do të jepen një shtysë të madhe.
- Ndryshimet ligjore duhet të jenë të koordinuara me planin buxhetor për të shmangur kosto të papritura për biznesin. Duhet të ngrihen grupe pune për të analizuar dhe ndjekur propozimet për zbatim. Sistemi tatimor dhe doganor kanë patur disa përmirësime të konsiderueshme, si p.sh. në drejtim të rimbursimit të TVSH-së për eksportuesit fason, pa kontrolle kryesisht, dhe pagesa është reduktuar në afatin kohor të pritshëm. Megjithatë përse i përket procedurave, ka ende nevojë për automatizim dhe digjitalizim si në sistemin tatimor dhe në sistemin doganor.
- Nevoja për krijimi i fondeve për cluster-at. Biznesi shqiptar, fermeri, nuk mund të realizojë ndërkombëtarizim i vetëm, por duke u bashkuar (biznesi i vogël dhe i mesëm) në struktura të cluster-ave do të arrijë të mund të krijojë industri dhe sipërmarrje të vërtetë, si dhe lehtësim të procedurave në vijim. Iniciativa e cluster-ave dhe ngritja e fondeve për cluster-at janë përfshirë në planin e reformave 2024-2026. A ka një studim për këtë dhe se çfarë masash janë marrë?

Z. Sherif Bundo, Shoqata e Kontabilistëve, u shpreh se stabiliteti fiskal në Shqipëri ka nevojë për përmirësime. Ai propozoi:

- Një kod fiskal të konsoliduar për të parandaluar ndryshimet e vazhdueshme ligjore. Ai argumentoi se ndryshimet e shpeshta tatimore kanë shkaktuar tensione dhe mosbesim në sektorin e biznesit—pra një rritje të riskut sistematik. Nëse ligjet ndryshojnë shpesh, ne nuk arrijmë as t'i mësojmë, as t'i stabilizojmë e as të reflektojmë—dhe ajo që është akoma më e dëmshme—nuk arrijmë të formojmë kulturën e respektit dhe zbatimit të ligjit. Për këtë arsye ka ardhur koha që ligji për procedurat tatimore të kalojë në nivelin e një kodi fiskal, që do të thotë kod fiskal i ndërtuar mirë, shina të konsoliduara të karakterit fiskal, mbi të cilin të mos

ketë dorë të lirë administrata që të ndryshojë sa herë që vullnetet politike apo interesat elektorale kërkojnë ndryshime për qëllime të ndryshme. .

- Amortizimi i përshpejtuar duhet futur, por në sektorë të rëndësishëm siç janë linjat teknologjike, investimi në sektorin e turizmit, linjat e përpunimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale dhe sektorët e industrisë. Por në vendin tonë u aplikua amortizimi i përshpejtuar për veturat, sikur ato të ishin aktiviteti i sektorit më të interesant i investimit në ekonominë shqiptare. Nëse do të aplikohesh për sektorë vërtet të rëndësishëm, atëherë, po, le të futet në ligj që nëse zgjidhet një regjim i amortizimit të përshpejtuar, shpenzimet që reduktojnë nga ky regjim të konsiderohen të zbritshme. Le të vendoset një mekanizëm kontrolli që të mos abuzohet.
- Ka ardhur koha të kuptohet pse nuk pati koeficient të lartë të aplikimit për të përfituar fonde nga projekte te BE-së. Biznese në përgjithësi nuk kanë të gjithë kulturën e nevojshme profesionale. Mirëpo, këtu ka dy palë. Një palë janë ata që i bëjnë thirrjet, ndërsa një palë janë ata që i thithin thirrjet. Nëse pala që i thith thirrjet nuk i kupton, kjo do të thotë që edhe ne nuk e kemi bërë misionin tonë. Ndoshta ka ardhur koha që të ketë zyra nëpër bashki që të ndihmojnë në aplikimet për fondet evropiane për të rritur produktivitetin dhe për të shmangur favorizimin e bazuar në njohje personale. Kjo do të ishte edhe në interesin e qeverisë e cila kërkon rritje të produktivitetit.

Z. Balazs Revesz, FIAA, vlerësoi rekomandimet e dhëna dhe vendosjen e produktivitetit në qendër të tyre duke qenë se produktiviteti duhet të jetë në harmoni të plotë me politikat fiskale dhe kuadrin ligjor. Ai ngriti disa pika të rëndësishme:

- Nevoja për të forcuar disponueshmërinë e fuqisë punëtore të kualifikuar dhe për të mbajtur talentet e reja në Shqipëri. Ka nevojë për një orientim më të mirë të përputhjes së kërkesës me ofertën në tregun e punës. Kjo kërkon një reformë rrënjësore dhe afatgjatë dhe jo vetëm ndërhyrje afatshkurtra. Do të ftonim qeverinë që të fokusohet në këtë drejtim dhe të niste ndërhyrjet e nevojshme.
- Mjedisi makroekonomik është i mirë, megjithatë sfida kryesore, sidomos për eksportuesit është zhvlerësimi i Euro kundrejt lekut, i cili është kthyer edhe në fokus të punës së BSH të cilën e vlerësojmë dhe do të donim që të vazhdohej të punohej në këtë drejtim.
- Digjitalizimi është një mjet i rëndësishëm për përmirësimin e inovacionit dhe produktivitetit. Përdorimi i shërbimeve digjitale ndihmon gjithashtu për të parandaluar evazionin fiskal. Fokusimi i qeverisë në drejtim të digjitalizimit të administratës së vet është shumë i rëndësishëm pasi kjo sjell ulje të informalitetit dhe rritje të shpejtësisë së marrjes së vendimeve, këto janë ato për të cilat bizneset kanë vërtet nevojë.
- Nevoja për harmonizim ligjor tatimor. Një sistem tatimor më të parashikueshëm dhe forcimin e zbatimit të ligjit për të siguruar një bazë më të gjerë tatimore dhe për të luftuar evazionin fiskal.

Z. Hubert Perr, Delegacioni i BE-së, u shpreh se KI është një platformë shumë e mirë për diskutime të hapura dhe të sqarta dhe falenderoi të gjithë pjesëmarrësit, përfshirë Sekretariatën, për punën e mirë që ka bërë. Në lidhje me temën, ai ngriti disa pika:

- Stabiliteti dhe parashikueshmëria e regjimit tatimor. Komisioni Evropian, në disa raste, edhe gjatë diskutimeve për formulimin e Axtendës së Reformës së Planit të Rritjes, ka inkurajuar autoritetet që të finalizojnë dhe miratojnë një strategji afatmesme të të ardhurave. Thëksojmë rëndësinë e rritjes graduale dhe strukturore të të ardhurave fiskale, të cilat, natyrisht, duhet të mbeten konkurruese. Kjo është thelbësore për aftësinë për të pasur investime publike në infrastrukturë dhe në zhvillimin e kapitalit njerëzor.
- Përsa i përket ndryshimeve në ligjin e procedurave tatimore ose Ligjin për TVSH-në, autoritetet inkurajohen të ndjekin përafrimin e acquis me direktivat e BE-së, si për shembull me Direktivën e BE-

së për TVSH-në. Procesi i miratimit të ndryshimeve dhe harmonizimit duhet të shkojë paralelisht.

- Për të ruajtur një regjim tatimor konkurrues, është e rëndësishme që përpjekjet të përqendrohen në zgjerimin e bazës tatimore, kryesisht nëpërmjet luftës kundër informalitetit dhe evazionit fiskal, dhe duke reduktuar gamën e përjashtimeve tatimore.
- Produktiviteti. Qeveria pa dyshim mund të luajë një rol, por duhet të jetë e orientuar, sepse burimet janë të kufizuara, dhe duhet të ketë një skemë, transparente, të qartë dhe e lehtë për t'u kuptuar.
- Inovacioni. Programi "EU for Innovation" synon të sjellë inovacion, duke u fokusuar ngushtësisht me inkubimin e ideve dhe bizneseve të vogla. Ideja është të punohet ngushtësisht me qeverinë për të lënë pas një sistem që i mundëson qeverisë rritjen.

Në lidhje me Planin e Rritjes:

- BE do të investojë 6 miliardë euro për Ballkanin Perëndimor (BP) për 3.5 vitet e ardhshme. Shumica e reformave që po diskutohen tani janë negociuar në këtë kuadër mes Shqipërisë dhe BE-së.
- Një nga pjesët më transformuese të Planit është qasja me tregun e BE-së, gjetja e mundësive të shpejta dhe reale për të hyrë në këtë treg, gjë e cila u theksua edhe gjatë samitit të fundit mbajtur në Tiranë. Për shembull, sistemi unik i pagesave (*Single Payment system*) është diçka shumë konkrete që po zhvillohet përmes punës së palodhshme të Bankës Qendrore të Shqipërisë. Kjo do ta bëjë Shqipërinë një destinacion tërheqës për biznes dhe turizëm dhe do të tërheqë edhe diasporën për të dërguar dhe marrë para. Këto janë llojet e iniciativave që mund të prisni nga BE-ja. Qasja në treg është e pamundur nëse sektori privat nuk është i gatshëm për të hyrë në këtë treg. Është e mundur që më shumë produkte të vijnë nga BE-ja, dhe prandaj produktiviteti i ndërmarrjeve shqiptare është shumë i rëndësishëm për të punuar në këtë drejtim.
- Reforma në Programin e Rritjes. BE do të ofrojë hapësira fiskale/financiare shtesë për 6 vendet e BP në qindra milionë euro nëpërmjet mbështetjes buxhetore, kundrejt masave dhe reformave të prekshme, të besueshme dhe të miratuara që qeveria po ndërmerr. Kështu që do të keni reforma që lidhen me sektorin privat dhe zona të tjera si kapitali, digjitalizimi, energjia, drejtësia dhe sundimi i ligjit, por në të njëjtin kohë qeveria do të ketë hapësirë financiare shtesë për të vendosur sisteme që qeveria të mbështesë sektorin privat në skema që do të nxisin produktivitetin dhe inovacionin. Këto skema që BE mbështet janë si ato që aplikohen nga shtetet anëtare. Aktualisht, BE po ofron mbështetje dhe partneritet për Shqipërinë sikur Shqipëria të ishte një anëtare e BE-së. Kështu që, në thelb, po lëvizim nga programet e mbështetjes mikro në mbështetjen makro që do t'ju lejojë të bëni atë që është më e mira për vendin tuaj.

Ministri Blendi Gonxhja, theksoi rëndësinë e standardeve dhe protokolleve teknike dhe profesionale. Ai vuri në dukje se mungesa e standardeve mund të çojë në rrezikimin e investimeve dhe besueshmërisë së vendit tek investitorët. Ministri Gonxhja shprehu nevojën për standardizim dhe kontroll të cilësisë së produkteve për të siguruar që investitorët të kenë besim në tregun vendas. Ai gjithashtu bëri thirrje për përmirësimin e inspektorateve dhe autoriteteve që mbikëqyrin standarde të cilat janë thelbësore për besueshmërinë e tregut. Ministri propozoi që t'i theksohet edhe problemit të mungesës së protokolleve dhe kontratave, duke e vlerësuar këtë si një sfidë për të dyja palët dhe si një aspekt që prek interesat e të gjithë palëve të përfshira në treg.

Z. Grant Van Cleve, Dhoma Amerikane e Tregtisë, falenderoi për ftesën dhe për hapat pozitivë që qeveria ka ndërmarrë në ndarjen e dy ministrive (financave dhe ekonomisë) dhe përfshirjen e inovacionit në ministrinë e Ekonomisë. Ai vuri në dukje disa problematika:

- Inovacioni dhe inteligjenca artificiale kërkojnë koordinim më të madh. Këto kategori kërkojnë kordinim në një nivel më të lartë pasi përfshijnë disa ministri dhe duhen platforma si këshilli apo grupet e punës për të rritur nivelin e koordinimit.
- Finalizimi i ligjeve mbi e-commerce dhe crowdfunding. Ka pasur ecuri, por që duhen finalizuar përtej masave të marra deri tani.
- Transferimi i njohurive përmes importimit të aftësive nga jashtë, si tërheqja e nomadëve digjitalë apo sjellja e zyrove qendrore rajonale (*headquarters*) të kompanive të mëdha nga vende të tjera në Shqipëri. Njerëzit e mençur shkojnë aty ku jetesa është e përshtatshme dhe kompanitë u shkojnë nga pas. Shqipëria ka një klimë të favorshme dhe kushte të mira jetese, të cilat po tërheqin të huajt. Njerëzit vijnë për të qëndruar pak por ambjentohen shpejt dhe sjellin inovacion, para ose kapital. Prandaj një pjesë e rëndësishme e strategjive duhet të fokusohen në përmirësimin e “përthithjes së trurit” dhe përdorimit të tij për përfitime të vendit.

Znj. Antonela Hako, Dhoma Ekonomike e Gruas, u përqendrua në rëndësinë e programeve të startup-eve dhe nevojën për të siguruar që këto programe të jenë të aksesueshme për të gjithë, duke përfshirë jo vetëm zonjat në qytet, por edhe ata në rrethe. Ajo propozoi që dhomat e tregtisë, përfshirë dhomat e grave, të jenë partnere në sqarimin dhe ofrimin e ndihmës për të interesuarit në grante, duke përdorur burimet e tyre (praktikantë) dhe duke ofruar trajnime. Znj. Hako gjithashtu propozoi mbështetje për bizneset ekzistuese vendase, veçanërisht në sektorin e agropërpunimit, të cilat kanë investuar në zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe në mjedisin e punës, por që kanë nevojë për një rishikim të bazës ligjore për t’i bërë ato konkurrues në tregun evropian.

Ministria Delina Ibrahimaj, sqaroi disa pika në përgjigje të komenteve të ngritura. Ajo vuri në dukje nevojën për një strategji afatmesme të të ardhurave që të fokusohet në stabilitet dhe eliminimin e përjashtimeve tatimore që dëmtojnë ekonominë e vendit në afat të gjatë. Gjithashtu, ajo theksoi nevojën për një qendër trajnime për biznesin dhe një qendër edukimi për të ndihmuar bizneset ekzistuese dhe startup-et në fillimin e biznesit të tyre. Ajo propozoi përmirësimin e instrumenteve financiare për mbështetjen e bizneseve, duke përfshirë krëjimin e një ligji për “crowdfunding” dhe krëjimin e “corporate venture capital” për të ndihmuar në financimin e startup-eve.

Znj. Bilgen Aldan, ICC Albania, theksoi dy çështje kryesore në lidhje me produktivitetin dhe aksesin në financë për bizneset në Shqipëri. Ajo përmendi një studim të ICC i cili tregon se shumica e bizneseve në vend kanë vështirësi në aksesin në fonde të Bashkimi Evropian, pavarësisht se po punojnë për të bërë modifikime rregullatore për t’u përshtatur. ICC Albania vlerëson rekomandimet për përmirësimin e aksesit në financë, por theksoi se shpejtësia, kuptueshmëria dhe praktikiteti janë thelbësore për të siguruar që bizneset t’i kuptojnë dhe t’i përfitojnë ato. Në aspektin sektorial, ajo sugjeroi që inteligjenca artificiale (AI) të konsiderohet si një shtyllë më vete horizontale duke përfshirë kompanitë në fushën e teknologjisë, dhe jo nën sektorë të ndryshëm. Kjo qasje e konsideron AI si një fushë të specializuar me implikime për financimin dhe strategjinë e përgjithshme të vendit.

Z. Zak Topuzi, Shoqata Shqiptare e Turizmit, shprehu pëlqimin që disa nga rekomandimet e shoqatës së turizmit janë përfshirë në notën teknike të Sekretariatit. Ai theksoi një rekomandim lidhur me produktivitetin e fuqisë punëtore dhe sezonalitetin në turizëm. Shqipëria ka një nivel të lartë sezonaliteti, e cila e rendit atë në vendin e 108 nga 117 vende të listuara. Kjo kërkon masa emergjente për të adresuar mungesën e fuqisë punëtore, duke përfshirë lehtësime fiskale apo subvencione. Ai përmendi njoftimin e fundit nga Ministria Greke e Turizmit për asistencë financiare për punëtorët e turizmit sezonal, duke e konsideruar këtë si një shembull të nevojës për masa emergjente për të trajtuar këtë çështje.

Z. Edvin Prençe, Pro-Eksport Albania, shprehu falënderimin për punën e Sekretariatit, por gjithashtu theksoi nevojën e shtimit të një pike në axhendën e mbledhjeve të KI ku të jepet informacion për punën e bërë dhe atë që nuk është bërë nga mbledhja e kaluar. Ai merr si shembull

problematikat që kanë të bëjnë me AKSHI-n, për të cilat nuk ka informacion se çfarë është bërë me to. Ai sugjeroi që për të rritur besueshmërinë e institucionit dhe të KI-së, duhet të bëhet një analizë e punës së kryer dhe asaj që nuk është bërë, duke identifikuar arsyet për mungesën e veprimit. Z. Prençe gjithashtu vlerësoi rëndësinë e anketave për të matur aksesin dhe dëshirën e biznesit për t'u përgjigjur, duke theksuar nevojën për të fituar besueshmërinë e tyre.

Znj. Diana Leka, Sekretariati i KI, falenderoi për komentin dhe sqaroi se rekomandimet kërkojnë kohën e tyre për t'u zbatuar. Megjithatë, përjashtime mund të ndodhin, dhe disa rekomandime mund të mos plotësohen brenda afatit të caktuar. Sekretariati do të verifikojë rekomandimet dhe do të japin përgjigje specifike sipas kërkesës së grupeve të interesit.

Ministri Blendi Gonxhja, ndau mendimet e tij për sfidat dhe prioritetet e vitit aktual. Ai theksoi rëndësinë e investimeve në kapitalin njerëzor dhe fuqizimin e forcës punëtore në Shqipëri. Gonxhja përshëndeti miratimin e dy TEDA-ve si lajm të mirë për ekonominë dhe punësimin cilësor, ndërsa përmendi nevojën për bashkëpunim të gjerë për të përballuar sfidat. Ai propozoi që të konsiderohet një gamë e gjerë politikash dhe programesh për të rritur aftësitë profesionale dhe të investohet në këtë drejtim. Gonxhja gjithashtu theksoi rëndësinë e inovacionit për thjeshtësimin e procedurave dhe praktikave, si dhe nevojën për një përkushtim të përbashkët për investime në zhvillimin profesional. Ai përfundoi me një thirrje për bashkëpunim të fortë dhe ftoi të gjithë të pranishmit për të vazhduar diskutimet dhe hapat e mëtejshëm.

Mbyllja e mbledhjes

Në përfundimin të të gjitha komenteve, Ministri Gonxhja falenderoi të gjithë të pranishmit dhe e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

Lista e pjesëmarrjes

Përfaqësues të qeverisë

1. Z. Blendi Gonxhja, Kryetar i Këshillit të Investimeve/Ministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
2. Znj. Delina Ibrahimaj, Ministër Shteti për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit
3. Znj. Natasha Ahmetaj, Zëvendës Guvernatore e Bankës së Shqipërisë
4. Znj. Anila Shqypi, Përgjegjëse sektori, Drejtoria NVM dhe Projekteve, deleguar nga znj. Laura Plaku, CEO, AIDA

Përfaqësues të biznesit

1. Z. Nikolin Jaka, Kryetar, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë
2. Znj. Elisabeta Katiaj, Nënkryetare, deleguar nga z. Ardian Lekaj, Kryetar, Dhoma Shqiptare e Biznesit të Diasporës
3. Z. Balazs Revesz, President, Shoqata e Investitorëve të Huaj (FIAA)
4. Znj. Antonela Hako, Kryetare, Dhoma Ekonomike e Gruas (DHEG)
5. Znj. Bilgen Aldan, Kryetare, ICC Albania
6. Z. Grant Van Cleve, President, AmCham Albania
7. Znj. Gerta Bilali, Drejtore Ekzekutive, deleguar nga z. Sergio Fontana, President, Confindustria Albania
8. Z. Denald Tafani, Kryetar, Shoqata e Biznesit Grek në Shqipëri
9. Z. Valer Pinderi, Kryetar, Shoqata e Tregtisë Elektronike (AECA)
10. Z. Zak Topuzi, Kryetar, Shoqata Shqiptare e Turizmit (ATA) (*ad-hoc*)
11. Z. Sherif Bundo, Kryetar, Shoqata e Kontabilistëve & Financierëve (*ad-hoc*)

Partnerë ndërkombëtarë

1. Z. Hubert Perr, Shef i Bashkëpunimit, Delegacioni i BE-së
2. Znj. Ekaterina Solovova, Drejtore e Zyrës së BERZH-it në Shqipëri
3. Znj. Hilda Shijaku, Ekonomiste e Lartë, deleguar nga z. Emanuel Salinas, Menaxher i Bankës Botërore
4. Znj. Laura Qorlaze, Përfaqësuese, IFC

Nuk morën pjesë:

1. Znj. Ines Muçostepa, Kryetare, Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë
2. Z. Bledar Shella, Kryetar i Bordit Mbikëqyrës, Shoqata Shqiptare e Bankave

Të ftuar të veçantë:

1. Z. Endrit Yzeiraj, Zv/Ministër i Financave dhe Ekonomisë
2. Z. Ceno Klosi, Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT)
3. Z. Piotr Szpunar, Drejtor Bordi për Poloninë, Bullgarinë dhe Shqipërinë, BERZH
4. Z. Philip Arnold, Zëvendës Shef Misioni, Ambasada Zviceriane

Të ftuar të tjerë:

5. Znj. Alketa Përnaska, Shefe Kabineti, MEKI
6. Znj. Rezana Celmeta, Drejtor, Drejtoria për Proceset e Biznesit, DPT
7. Z. Bledar Hamzallari, Drejtor Drejtoria e Kontrollit, DPT

8. Z. Trëndafil Tarja, Drejtor Drejtorja e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, DPT
9. Znj. Albana Laknori, Sekretare e Përgjithshme, Dhoma e Tregtisë Tiranë
10. Z. Berti Pashko, Kryetar, Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA)
11. Z. Edvin Prençe, Kryetar, Pro-Eksport, Albania
12. Z. Bashkim Sykja, Shef Kabineti, Dhoma e Tregtisë Tiranë
13. Z. Artan Luku, Kryetar, Dhoma e Tregtisë Durrës
14. Znj. Ardita Seknaj, Sekretare e Përgjithshme, ICC Albania
15. Znj. Soana Tekaj, Drejtore Ekzekutive, Dhoma e Biznesit të Diasporës
16. Z. Artur Papajani, Ekspert Fiskal
17. Z. Gledis Shehu, Ekspert
18. Znj. Mimoza Agolli, Eksperte Ekonomie
19. Znj. Erifili Berberi, Drejtore Ekzekutive, Shoqata e Biznesit Grek në Shqipëri
20. Z. Reinaldo Pipiria, Kryetar, Shoqata e Pasurive të Patundshme
21. Znj. Marlinda Zotaj, Head of Office, Advantage Austria
22. Znj. Tiziana Domi, Koordinatore Projekti, SWISSA
23. Z. Martin Serreqi, Zv. Dekan për Marrëdhëniet me Sipërmarrjen dhe Institucionet Publike, Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Tiranës
24. Znj. Arjeta Vokshi, Profesor, Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Tiranës
25. Z. Bardhi Sejdarasi, Gazetar, RTSH
26. Z. Keler Gjika, Ekspert Fiskal, Banka Botërore
27. Znj. Sigita Stafa, Manaxhere Programi, Ambasada e Zvicërës në Shqipëri
28. Znj. Ledia Muço, Këshilltare për Çështjet Ekonomike, Delegacioni i BE-së
29. Znj. Endrita Xhaferaj, Këshilltare e Lartë, BERZH